

VENDIM
Nr. 30/2022

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 69/2021, “PËR CAKTIMIN
E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës; të neneve 21, pika 2, dhe 55, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 69/2021, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, bëhen këto ndryshime:

I. Deputeti Pandeli Majko caktohet anëtar në Komisionin e Politikës së Jashtme dhe anëtar zëvendësues në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

II. Deputeti Benet Beci nga anëtar zëvendësues caktohet anëtar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

III. Deputetja Etilda Gjonaj caktohet anëtare e Komisionit për Politikën e Jashtme në vend të deputetit Benet Beci.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 14.4.2022.